



## Udhëzimi 17

Shtator 2016

### Prokurimi publik

# Prokurimi elektronik

#### PËRMBAJTJA

- [Prokurimi elektronik](#)
- [Përdorimi i prokurimit elektronik](#)
- [Shembuj të kursimeve dhe të përmirësimeve](#)
- [Prokurimi elektronik në Direktivë](#)
- [Shpallja elektronike](#)
- [Disponueshmëria elektronike e dokumenteve të prokurimit](#)
- [Dorëzimi elektronik i kërkesave për të marrë pjesë në tender](#)
- [e-CERTIS – depozita në internet e certifikatave](#)
- [Dokumenti Unik Evropian i Prokurimit](#)
- [Mjetet e prokurimit](#)
- [Faturat elektronike](#)
- [Informacion i mëtejshëm](#)

Autorizuar për botim nga Karen Hill, Drejtuese e Programit të SIGMA-s.

## Prokurimi elektronik

**Çfarë është prokurimi elektronik (e-prokurimi)?** Nëse shprehet në mënyrën më të thjeshtë të mundshme, e-prokurimi është një term gjithëpërfshirës që nënkupton zëvendësimin, në të gjithë procesin e prokurimit, e procedurave të bazuara në letër me komunikimin dhe përpunimin që bazohen në teknologjinë e informacionit. Prokurimi elektronik mund të jetë një mjet për t'i bërë proceset më efikase dhe për të promovuar efikasitetin e prokurimit.

Teknologjia e e-prokurimit dhe proceset mund të përdoren, kur është e përshtatshme, në faza të ndryshme të procesit të prokurimit, duke përfshirë publikimin e njoftimeve të tenderit, sigurimin e dokumenteve të tenderit, paraqitjen e ofertave dhe të kërkesave për pjesëmarrje, procesin e vlerësimit, njoftimin e shpalljes së fituesit, porositjen, faturimin dhe pagesën.

## Përdorimi i prokurimit elektronik

**Pse të përdoret prokurimi elektronik?** Përdorimi i sistemeve dhe i proceseve të e-prokurimit mund të rezultojë në një numër avantazhesh, duke përfshirë:

- **Reduktimin e kostove administrative** të procedurave të veçanta të prokurimit;
- **Procedura të përmirësuara të prokurimit;**
- **Procedura më të shpejta** të prokurimit;
- **Transparencën e rritur**, duke siguruar informacion në lidhje me mundësitë individuale të tenderit, por edhe duke siguruar një pamje më të qartë të ofertave në një bazë më të gjerë;
- **Monitorim më të mirë të prokurimit;**
- **Nxitjen e konkurrencës ndërkufitare**, duke reduktuar barrierat e paraqitura nga proceset e prokurimit të bazuara në letër;
- **Mbështetjen për zhvillimin e administrimit të centralizuar të prokurimit**, duke rezultuar në reduktimin e mundshëm të funksioneve të kushtueshme prokurimit në zyrë dhe përdorimin e mirë të ekonomive të shkallës në administrimin e prokurimit;
- **Modernizimin dhe thjeshtimin më të gjerë administrativ**, duke inkurajuar integrimin e proceseve të ndryshme administrative, si dhe përhapjen e zgjidhjeve të teknologjisë së informacionit brenda qeverisë dhe nga qeveria e shoqëria në përgjithësi.

## Shembuj të kursimeve dhe të përmirësimeve

Në vitin 2010, Komisioni Evropian, në Dokumentin e Gjellbër të Prokurimit Elektronik<sup>1</sup>, ka dhënë shembuj të përfitimeve të futjes së prokurimit elektronik, siç tregohet më poshtë.

Agjencia italiane Emilia Romagna-së Intercent ER ofron shërbime të e-prokurimit, duke përfshirë tregun elektronik, katalogët elektronikë dhe ankandet elektronike (e-tregun, e-katalogët dhe e-ankandet) dhe tani është pikë referimi për 539 administrata (90% e agjencive lokale). Në vitin 2008 ajo përpunoi transaksione në shumën e rreth 419 milionë Eurove, duke siguruar përfitime si rezultat i efikasitetit prej 67.5 milionë Eurove dhe kursime të kohës të përlllogaritura në rreth 45 vite jetë njerëzore.

Agjencia Federale Austriake e Prokurimit përqendroi blerjet për autoritetet federale përmes funksioneve të e-prokurimit. Në vitin 2008 ajo raportoi një kursim prej 178 milionë Eurosh

<sup>1</sup> Komisioni Evropian (2010), *Dokumenti i Gjellbër mbi zgjerimin e përdorimit të prokurimit elektronik në BE*, COM (2010) 571 final, Bruksel.

kundrejt një vëllim të prokurimit prej 830 milionë Eurosh. Përfitimet ishin ndjeshëm më të mëdha se kostot vjetore të mirëmbajtjes prej 5 milionë euro, të cilat janë më pak se 3% të kursimeve.

Që nga data 1 shkurt 2005, të gjitha autoritetet kontraktore në Danimarkë mund të pranojnë vetëm faturat elektronike. Kjo reformë prek rreth 15 milionë fatura në vit, dhe vlen për të gjithë sektorin publik, nga ministritë deri tek çerdhet. Përdorimi i e-faturimit pritet t'i kursejë publikut 100 milionë Euro çdo vit, përveç kursimeve në proceset e brendshme administrative.

Në Norvegji, platforma Ehandel po i ndihmon autoritetet që të arrijë 20-40% ulje të kohës që duhet për të trajtuar porositë, marrjen dhe faturimin e mallrave dhe duke krijuar kursime nëpërmjet çmimeve në rreth 2-10%.

Në Mbretërinë e Bashkuar, faqja e internetit e quajtur Zgjdhjet për Blerjet ka raportuar në raportin e saj vjetor 2008/09 se kishte lehtësuar shitjet me një vlerë mbi 5 miliard paund britanik, duke siguruar kursime prej rreth 732 milion paundësh britanik. Mbretëria e Bashkuar ka raportuar gjithashtu se kursimet shpesh i kalojnë 10% (dhe madje edhe deri në 45%), si rezultat i përdorimit të ankandëve elektronike dhe kohët e fundit ka njoftuar për planet lidhur me përdorimin e ankandëve elektronike për t'u kursyer tatimpaguesve deri në 270 milion paund britanik deri në fund të vitit 2011.

Një studim Portugez krahasoi ofertat më të mira për punët publike të kontraktuara nga 50 spitalet publike portugeze në vitin 2009 (duke përdorur sistemet e bazuara në letër) dhe në vitin 2010 (duke përdorur prokurimin elektronik). Studimi arriti në përfundimin se në vitin 2010 ishte arritur një ulje e kostos prej 18%, për shkak të rritjes së konkurrencës të krijuar me prokurimin elektronik.

Vlen të përmendet se kursimet e tilla si ato të përshkuara më lart janë arritur zakonisht duke përdorur një kombinim të prokurimit elektronik, marrëveshjeve kuadër dhe blerjes së përqendruar. Për më shumë informacion, shihni Udhëzimin nr. 19 të SIGMA-s për Prokurimin Publik, *Marrëveshjet Kuadër*, dhe Udhëzimin nr. 20 të SIGMA-s për Prokurimin Publik, *Organet Qendrore Blerëse*.

## Prokurimi elektronik në Direktivë

**Prokurimi elektronik dhe reforma e rregullave të prokurimit e vitit 2014:** Ndonëse Direktiva e Sektorit Publik 2004<sup>2</sup> thjesht inkurajoi përdorimin e mjeteve elektronike në procedurat e prokurimit publik, reforma e rregullave të prokurimit e vitit 2014 ka paraqitur mjetet elektronike si mjetet standarde të komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit në procedurat e prokurimit.

Bashkimi Evropian (BE) ka përfshirë ndryshime të rëndësishme në Direktivën e Sektorit Publik 2014 (Direktiva)<sup>3</sup> për të lehtësuar përdorimin e prokurimit elektronik në proceset e tenderimit. Për këtë qëllim, Direktiva ka **kërkesa të detyrueshme** për:

- Transmetimin e njoftimeve në formë elektronike;
- Disponueshmërinë elektronike të dokumenteve të prokurimit;
- Dorëzimin elektronik të kërkesave për pjesëmarrje dhe të ofertave.

Shënim: periudha e zbatimit të rregullave për komunikimin elektronik:

Neni 90 i Direktivës përcakton periudhat për zbatimin e dispozitave të komunikimit elektronik nga ana e Shteteve Anëtare.

<sup>2</sup> Direktiva 2004/18/EC mbi koordinimin e procedurave për dhënien e kontratave të punëve publike, kontratave të furnizimit publik dhe kontratave të shërbimit publik, 31 mars 2004

<sup>3</sup> Direktiva 2014/24/BE për prokurimet publike dhe shfuqizimin e Direktivës 2004/18/KE, 26 shkurt 2014

Periodha e përgjithshme për transpozimin e Direktivës është 24 muaj, d.m.th., deri më 18 prill të vitit 2016, ndërkohë është caktuar një periudhë 54-mujore për zbatimin e kërkesave të komunikimit elektronik. Shtetet Anëtare mund të shtyjnë zbatimin e kërkesave të detyrueshme të komunikimit elektronik jo më vonë se deri më 18 tetor 2018.

Ka përjashtime për këtë periudhë shtyrjeje 54-mujore: në rastet kur komunikimi elektronik është i detyrueshëm sipas Direktivës, d.m.th., për sistemet dinamike të blerjeve, për ankandet elektronike (e-ankandet), e-katalogët, procedurat e prokurimit të kryera nga organet qendrore blerëse, hartimin dhe transmetimin e njoftimeve, dhe disponueshmërinë elektronike të dokumenteve të prokurimit, vlen periodha normale e transpozimit prej 24 muajsh, pra deri më 18 prill 2016.

Në lidhje me organet e blerjes qendrore, të cilave u lejohen vetëm 36 muaj (në vend të 54 muajve) për të zbatuar dispozitat e Direktivës për komunikimin elektronik është hartuar një dispozitë e veçantë. Prandaj, Shtetet Anëtare mund t'i shtyjnë kërkesat e detyrueshme të komunikimit elektronik jo më vonë se deri më 18 prill të vitit 2017 për organet qendrore blerëse.

Së fundi, kur një Shtet Anëtar zgjedh të shtyjë zbatimin e kërkesave të komunikimit elektronik, ai duhet gjithsesi të sigurojë që autoritetet kontraktore mund të zgjedhin për një periudhë të ndërmjetme midis mjeteve të mëposhtme të komunikimit për të gjitha shkëmbimet e komunikimit dhe të informacionit: (1) në mënyrë elektronike, (2) me postë ose me çdo dërgues tjetër të përshtatshëm, (3) me faks, ose (4) një kombinim të secilës prej këtyre mjeteve.

Shtetet anëtare dhe autoritetet kontraktore janë të lira për të shkuar më tej, nëse ata dëshirojnë ta bëjnë këtë. Megjithatë, përdorimi i detyrueshëm i mjeteve elektronike të komunikimit nuk i detyron autoritetet kontraktore që të kryejnë përpunimin elektronik të ofertave, vlerësimin elektronik ose përpunim automatik. Ky detyrim nuk mbulon çdo fazë të procesit të prokurimit publik, pas dhënies së kontratës ose të komunikimit të brendshëm brenda autoritetit kontraktor.

Mjetet dhe pajisjet që do të përdoren për të komunikuar në mënyrë elektronike, si dhe karakteristikat e tyre teknike duhet të jenë jo diskriminuese, përgjithësisht të disponueshme dhe ndërvepruese me produktet e teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në përdorim të përgjithshëm, ndërkohë që ato nuk duhet të kufizojnë aksesin e operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit. Në të gjithë komunikimin, shkëmbimin dhe ruajtjen e informacionit, autoritetet kontraktore duhet të sigurojnë ruajtjen e integritetit të dhënave dhe konfidencialitetin e ofertave si dhe të kërkesave për pjesëmarrje.

Kur autoritetet kontraktore kërkojnë përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve që nuk janë përgjithësisht të disponueshme, ato duhet të ofrojnë mjetet alternative të aksesit.

### **Shërbimet**

Dispozita të ngjashme për mjetet elektronike të komunikimit janë futur edhe në Direktivën e Shërbimeve. Transmetimi i njoftimeve në formë elektronike, disponueshmëria elektronike e dokumenteve të prokurimit, dhe komunikimi plotësisht elektronik - që do të thotë komunikim me mjete elektronike në të gjitha fazat e procedurës, duke përfshirë transmetimin e kërkesave për pjesëmarrje dhe, në veçanti, transmetimin e ofertave (paraqitja elektronike) - janë bërë të detyrueshme.

## **Shpallja elektronike**

**Dorëzimi elektronik i njoftimeve:** Direktiva kërkon publikimin e njoftimeve të specifikuar në *Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian (GZBE)* në lidhje me kontratat që janë të një lloji dhe vlere për të cilat zbatohen rregullat e prokurimit të BE-së. Këto njoftime të detyrueshme janë të nevojshme në përgjithësi në fillim të procesit të prokurimit për të njoftuar operatorët ekonomikë rreth mundësive në dispozicion, si dhe në përfundim të një procedure prokurimi. Mund të jenë të nevojshme edhe njoftime të tjera, për shembull, kur është bërë një modifikim i njoftimit të kontratës origjinale ose është ndërprerë një sistem dinamik blerjeje. Ekzistojnë edhe mundësitë që autoritetet kontraktore të publikojnë njoftimet vullnetarisht në *GZBE*. Shih gjithashtu Udhëzimin nr. të SIGMA-s për Prokurimin publik, *Shpallja*.

Njoftimet e formës standarde<sup>4</sup> duhet të hartohen dhe të transmetohen në mënyrë elektronike tek Zyra e Publikimeve të BE-së. Njoftimet publikohen jo më vonë se pesë ditë pasi ato janë dërguar. Zyra e Botimeve duhet t'i sigurojë autoritetit kontraktor konfirmimin e marrjes së njoftimit dhe të publikimit të tij.

Të gjitha njoftimet e formës standarde të publikimit në *GZBE* janë të disponueshme në formë elektronike në faqen e internetit SIMAP.<sup>5</sup> Portali SIMAP ofron akses në informacionet më të rëndësishme mbi prokurimin publik në BE.

Të gjitha njoftimet e publikuara në *GZBE* janë në dispozicion të publikut në internet.<sup>6</sup> Operatorët ekonomikë mund të regjistrohen në faqen e internetit që të njoftohen për mundësitë përkatëse të kontratës.

#### Shpallja elektronike në nivel kombëtar

Shumë Shtete Anëtare ose kërkojnë ose ofrojnë opsionin e shpalljes shtesë të kontratave në faqet kombëtare të internetit, duke përfshirë faqet e internetit të agjencisë kombëtare të prokurimit ose gazetën zyrtare.

Megjithatë, njoftimet nuk duhet të publikohen në nivel kombëtar para se të publikohen në *GZBE*. Pavarësisht kësaj, publikimi mund të bëhet në nivel kombëtar, kur autoritetet kontraktore nuk janë njoftuar për publikimin në *GZBE* brenda 48 orësh pas konfirmimit të marrjes së njoftimit.

Shpallja elektronike ose e-shpallja është gjithashtu një kërkesë e zakonshme për shumë kontratat nën kufijtë monetarë të BE-së, pasi ajo është një mjet i lirë dhe transparent për të siguruar transparencë dhe për të inkurajuar konkurrencën. Shih Udhëzimin nr. 15 të SIGMA-s për Prokurimin publik, *Kontratat nën pragun monetar*.

Shpallja para fillimit të procesit formal të prokurimit duke përdorur Njoftimin Paraprak të Informacionit apo profilin e blerësit: Direktiva përmban dispozita që e lejojnë, por nuk e detyrojnë, autoritetin kontraktor që të paralajmërojë në avancë tregun për mundësitë potenciale të kontratës së ardhshme duke përdorur Njoftimin Paraprak të Informacionit (NPI).

Si autoriteti kontraktor ashtu edhe operatori ekonomik potencial përfitojnë nga shpallja në avancë në këtë mënyrë, veçanërisht meqë NPI-ja ndihmon të dyja palët në planifikimin për të ardhmen. Nëse përdoret NPI-ja, atëherë afatet kohore ligjore të tenderit mund të reduktohen në rrethana të caktuara.

Përdorimi i **profileve të blerësit** në internet mund të jetë veçanërisht e dobishëm pikërisht në këtë kontekst. Autoriteti kontraktor mund të krijojë "profilin e blerësit" të tij të bazuar në

<sup>4</sup> Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2015/1986 e datës 11 nëntor 2015 për krijimin e formave standarde të publikimit të njoftimeve në fushën e prokurimit publik dhe shfuqizimin e Rregullores Zbatuese (BE) Nr. 842/2011.

<sup>5</sup> [www.simap.europa.eu](http://www.simap.europa.eu)

<sup>6</sup> [www.ted.europa.eu](http://www.ted.europa.eu)

internet. Profili do të përfshijë informacion të përgjithshëm për autoritetin kontraktor, së bashku me informacion në lidhje me ftesat e vazhdueshme për tenderim, blerjet e planifikuara, kontratat e lidhura dhe procedurat e anuluar.

Autoriteti kontraktor mund të publikojë NPI-në formë standarde në profilin e tij të blerësit. Kur autoriteti kontraktor përdor këtë metodë, ai duhet të dërgojë njoftim të shkurtër në formë standarde të profilit të blerësit tek *GZBE*-ja.

Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që autoritetet kontraktore nën-qendrore apo kategori specifike të autoriteteve të tilla mund të bëjnë thirrje për konkurrim me anë të NPI-së në disa procedura. Këto NPI duhet të publikohen në *GZBE* si një ftesë për konkurrim dhe jo vetëm në profilin e blerësit të autoritetit kontraktor.

**Shpallja në përfundim të procesit:** Autoritetet kontraktore duhet të publikojnë njoftimin e shpalljes së fituesit të procedurës së prokurimit, jo më vonë se 30 ditë pas lidhjes së kontratës ose të marrëveshjes kuadër. Përsëri, ky njoftim i shpalljes së fituesit duhet të publikohet në internet në format elektronike duke përdorur formularët standard.

Në rastin e marrëveshjeve kuadër, autoritetet kontraktore nuk janë të detyruara të publikojnë njoftimin e rezultateve të procedurës së prokurimit për çdo kontratë të bazuar në atë marrëveshje. Shtetet Anëtare mund të parashikojnë që autoritetet kontraktore të kenë mundësinë e njoftimeve në grup të rezultateve të procedurës së prokurimit për kontratat në bazë të marrëveshjes kuadër çdo tremujori. Këto njoftime të grupuara duhet të publikohen brenda 30 ditëve nga përfundimi i çdo tremujori.

Për sa i përket kontratave të bazuara në sistemin dinamik të blerjes, publikimi i njoftimit për shpalljen e fituesit brenda 30 ditëve është i detyrueshëm pas dhënies së çdo kontrate. Përsëri, njoftimet e tilla mund të grupohen në bazë tremujore, dhe njoftimet e grupuara duhet të publikohen brenda 30 ditëve nga përfundimi i çdo tremujori.

### Disponueshmëria elektronike e dokumenteve të prokurimit

Autoritetet kontraktore janë të detyruara të ofrojnë me anë të mjeteve elektronike "akses të pakufizuar dhe të plotë e të drejtpërdrejtë dhe pa pagesë në dokumentet e prokurimit" nga data e publikimit të njoftimit të kontratës ose nga data në të cilën është dërguar një ftesë për të konfirmuar interesin.<sup>7</sup> Njoftimi i kontratës ose i ftesës duhet të specifikojë adresën e internetit në të cilën janë të disponueshme dokumentet e prokurimit.

**Rrethanat ku nuk mund të ofrohet akses i pakufizuar, i plotë, i drejtpërdrejtë dhe falas me anë të mjeteve elektronike:** Direktiva përfshin një listë të gjerë të rrethanave ku autoritetet kontraktore mund të tregojnë në njoftimin ose në ftesën për të konfirmuar interesimin se dokumentet e prokurimit do të transmetohen me anë të një mjeti tjetër dhe jo me mjete elektronike. Ku arsyeja për mos dhënien e aksesit elektronik është konfidencialiteti, autoriteti kontraktor është i detyruar ta japë një informacion të tillë në kontratë ose në ftesën për të konfirmuar interesin. Informacioni duhet të tregojë se cilat masa kërkohen për mbrojtjen e konfidencialitetit dhe se si mund të sigurohet akses në dokumente. Kur nuk mund të ofrohen mjetet elektronike, atëherë afati kohor për dorëzimin e ofertave duhet që të zgjatet për pesë ditë, me përjashtim të rasteve të urgjencës të arsyetuar.

### Paraqitja elektronike e kërkesave për pjesëmarrje dhe e ofertave

<sup>7</sup> Kjo kërkesë ka të bëjë me disponueshmërinë e dokumenteve të prokurimit kur përdoret një NPI si mjet për të bërë ftesë për konkurrim.

Paraqitja e kërkesave për pjesëmarrje dhe e ofertave duhet të kryhet duke përdorur mjetet elektronike të komunikimit (shih shënimin më sipër për periudhën e zbatimit të rregullave të komunikimit elektronik).

Përjashtimet nga ky detyrim janë përcaktuar në Direktivë si më poshtë, ku:

- "për shkak të natyrës së specializuar të prokurimit, përdorimi i mjeteve elektronike të komunikimit do të kërkojë mjete, pajisje apo formate skedarësh të veçanta që nuk janë përgjithësisht të disponueshme ose që nuk mbështeten nga aplikacionet përgjithësisht të disponueshme";
- "aplikacionet që mbështesin formatet e skedarëve që janë të përshtatshëm për përshkrimin e ofertave përdorin formate skedarësh që nuk mund të trajtohen me anë të aplikacioneve të tjera të hapura apo përgjithësisht të disponueshme ose i përkasin një skeme të licencimit me pronësi dhe nuk mund të vihen në dispozicion për shkarkimin ose përdorim në distancë nga ana e autoritetit kontraktor";
- "përdorimi i mjeteve elektronike të komunikimit do të kërkojnë pajisje të specializuara zyre që nuk janë përgjithësisht në dispozicion të autoriteteve kontraktore";
- "dokumentet e prokurimit kërkojnë dorëzimin e modeleve fizike apo të shkallëzuara që nuk mund të transmetohen me anë të përdorimit të mjeteve elektronike".

Në rrethanat e renditura më sipër, komunikimi duhet të kryhet me postë ose në një tjetër dërgues të përshtatshëm ose me një kombinim të këtyre mjeteve dhe mjeteve elektronike.

Përveç kësaj, autoritetet kontraktore nuk janë të detyruara të kërkojnë dorëzimin elektronik, kur është i nevojshëm përdorimi i mjeteve të tjera të komunikimit "për shkak të një shkelje të sigurisë së mjeteve elektronike të komunikimit, ose mbrojtja e natyrës veçanërisht të ndjeshme të informacionit kërkon një nivel të tillë të lartë mbrojtjeje që nuk mund të garantohet siç duhet duke përdorur mjetet elektronike dhe pajisje të cilat janë përgjithësisht në dispozicion të operatorëve ekonomikë".

Autoriteti kontraktor duhet të japë arsyet për mospërdorimin e dorëzimit elektronik në raportin individual mbi procedurën e dhënies së kontratës.

## **Kërkesat në lidhje me mjetet dhe pajisjet e dorëzimit elektronik**

### **Aneksi IV i Direktivës**

"Mjetet dhe pajisjet për marrjen elektronike të ofertave, kërkesave për pjesëmarrje dhe dorëzimin e planeve dhe projekteve në konkurset e projektimit duhet të garantojë nëpërmjet mjeteve teknike dhe procedurave të përshtatshme, të paktën, sa më poshtë vijon:

- (a) Koha e saktë dhe data e pranimit të ofertave, kërkesave për pjesëmarrje dhe dorëzimit të planeve dhe projekteve mund të përcaktohet me saktësi;
- (b) Mund të sigurohet në mënyrë të arsyeshme se askush nuk mund të ketë akses në të dhënat e transmetuara në bazë të këtyre kërkesave para afateve kohore të përcaktuara;
- (c) Personat e autorizuar mund të caktojnë ose ndryshojnë vetëm datat për hapjen e të dhënave të marra;
- (ç) Gjatë fazave të ndryshme të procedurës së prokurimit të konkursit të projektimit, aksesit në të gjitha të dhënat e paraqitura, ose në një pjesë të tyre, duhet të jetë i mundur vetëm për personat e autorizuar;



- (d) Vetëm personat e autorizuar duhet të japin akses në të dhënat e transmetuara dhe vetëm pas datës së përcaktuar;
- (dh) Të dhënat e marra dhe të hapura, në përputhje me këto kërkesa, duhet të jenë të aksesueshme vetëm për personat e autorizuar që të familjarizohen me to;
- (e) Kur shkelen ndalimet e aksesit ose kushtet e përmendura në pikat (b), (c), (ç), (d) dhe (e) apo është bërë një përpjekje për ta bërë këtë, atëherë mund të sigurohet në mënyrë të arsyeshme se shkeljet ose përpjekjet janë qartësisht të zbulueshme.”

Përveç kësaj, për mjetet dhe pajisjet për dorëzimin elektronik zbatohen rregullat e mëposhtme:

- Informacioni mbi specifikimet, duke përfshirë enkriptimin dhe kohën e saktë, duhet të jenë në dispozicion të palëve të interesuara.
- Duhet të specifikohet niveli i kërkuar i sigurisë në faza të ndryshme të procedurës së veçantë të prokurimit, në proporcion me rreziqet e bashkëngjitura; kur niveli i rrezikut, siç vlerësohet në përputhje me pikën e theksuar më sipër, është i tillë që duhen nënshkrimet elektronike të avancuara<sup>8</sup>, atëherë autoritetet kontraktore duhet të pranojnë nënshkrimet elektronike të avancuara të mbështetura nga një certifikatë e kualifikuar, duke marrë parasysh nëse këto certifikata janë të lëshuara apo jo nga një ofrues i shërbimeve të certifikatave që është në listën e besuar,<sup>9</sup> të krijuar me ose pa një mjet të sigurt të krijimit të nënshkrimeve, duke iu nënshtruar kushteve të përcaktuara<sup>10</sup>.

### E-CERTIS – depozita në internet e certifikatave

E-Certis<sup>11</sup> është mjet referimi falas i informacionit në internet që është krijuar nga Komisioni Evropian në tetor të vitit 2010. Ky mjet interneti jep detaje të certifikatave të ndryshme dhe vërtetimeve që kërkohen shpesh në procedurat e prokurimit në të 28 Shtetet Anëtare të BE-së, në disa vendet kandidatë dhe vendet që janë anëtarë të Zonës Ekonomike Evropiane. Ajo i ndihmon palët e interesuara që të kuptojnë se çfarë informacioni kërkohet apo ofrohet dhe që të identifikojnë ekuivalentët reciprokisht të pranueshëm.

Në përputhje me Direktivën dhe me qëllim lehtësimin e tenderimit ndërkufitar, Shtetet Anëtare janë të detyruara që të sigurojnë se informacioni në lidhje me certifikatat dhe format e tjera të provave të dokumentuara të futura në e-Certis mbahen vazhdimisht të përditësuara. Autoritetet kontraktore do t'i drejtohen e-Certis dhe do të kërkojnë kryesisht lloje të tilla të certifikatave ose formave të provave të dokumentuara që janë të mbuluara nga e-Certis. Përdorimi i e-Certis nga autoritetet kontraktore do të bëhet i detyrueshëm që nga data 18 tetor 2018.

### Dokumenti Unik Evropian i Prokurimit

Operatorët ekonomikë, veçanërisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, konstatojnë se një nga pengesat kryesore për pjesëmarrjen e tyre në prokurimin publik është barra administrative që rrjedh nga nevoja për të paraqitur një numër të konsiderueshëm certifikatash ose

<sup>8</sup> Siç përcaktohet në Direktivën 1999/93/KE e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian e 13 dhjetorit 1999, në kuadrin e Komunitetit për nënshkrimet elektronike.

<sup>9</sup> Kjo listë është parashikuar në Vendimin e Komisionit Evropian të datës 16 tetor 2009 që përcakton masat që lehtësojnë përdorimin e procedurave me mjete elektronike përmes “pikave të vetme të kontaktit” në bazë të Direktivës 2006/123/KE të Parlamentit dhe të Këshillit Evropian për shërbimet në tregun e brendshëm.

<sup>10</sup> Për më shumë detaje shih nenin 22 (6) (c) të Direktivës 2014/24/BE.

<sup>11</sup> <http://ec.europa.eu/markt/ecertis/login.do>



dokumentesh të tjera që lidhen me kriteret e përjashtimit dhe të përzgjedhjes. Për të lehtësuar procesin e prokurimit, Direktiva ka prezantuar Dokumentin Unik Evropian të Prokurimit (DUEP).

Autoritetet kontraktore duhet të pranojnë DUEP-in si dëshmi paraprake në vend të certifikatave të lëshuara nga autoritetet publike ose palët e treta duke konfirmuar se operatori përkatës ekonomik i plotëson kushtet e mëposhtme:

- Nuk është në njërin nga situatat në të cilat operatorët ekonomikë përjashtohen ose mund të jenë, përjashtuar.
- Ai i plotëson kriteret përkatëse të përzgjedhjes.
- Ai plotëson, kur kërkohet, rregullat dhe kriteret objektive që janë të përcaktuara për reduktimin e numrit të kandidatëve të kualifikuar që duhet të ftohen që të marrin pjesë.

Dokumenti Unik Evropian i Prokurimit:

- Përbëhet nga një deklaratë zyrtare nga ana e operatorit ekonomik që tregon se nuk zbatohen shkaqet përkatëse të përjashtimit dhe/ose se është përmbushur kriteri përkatës i zgjedhjes.
- Siguron informacionin e duhur, siç kërkohet nga autoriteti kontraktor.
- Identifikon autoritetin publik apo personin e tretë përgjegjës për krijimin e dokumenteve mbështetëse.
- Përmban një deklaratë zyrtare që dëshmon se operatori ekonomik do të jetë në gjendje, sipas kërkesës dhe pa vonesë, që të sigurojë ato dokumente mbështetëse.
- Përmban informacione të tilla si adresa e internetit e të dhënave, të gjitha të dhënat e identifikimit dhe, kur kërkohet, deklaratën e nevojshme të pëlqimit sipas së cilës autoriteti kontraktor mund të marrë dokumentet mbështetëse duke hyrë drejtpërdrejt në bazën e të dhënave.

DUEP-i që jepet ekskluzivisht në formë elektronike dhe vihet në dispozicion në të gjitha gjuhët në e-Certis, duhet të hartohet në bazë të formularit standard të përcaktuar nga Komisioni Evropian.<sup>12</sup>

Autoriteti kontraktor duhet ta pranojë DUEP-in në momentin e dorëzimit të kërkesave për pjesëmarrje apo të ofertave nga ana e kandidatëve ose ofertuesve. Megjithatë, autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve ose kandidatëve në çdo moment gjatë procedurës që ata të dorëzojnë të gjitha ose një pjesë të dokumenteve mbështetëse. Ai mund ta bëjë këtë gjë kurdoherë që është e nevojshme për të siguruar kryerjen e duhur të procedurës. Për më tepër, para dhënies së kontratës, autoriteti kontraktor duhet të kërkojë nga tenderuesi, të cilit ka vendosur që t'ia jap kontratën, që të paraqesë dokumente mbështetëse të përditësuara.

Autoritetet kontraktore nuk duhet të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që ata të dorëzojnë dokumente mbështetëse ose prova të tjera kur autoriteti kontraktor e ka mundësinë e marrjes së certifikatave apo të informacionit të duhur direkt duke hyrë në bazën e të dhënave kombëtare në çdo shtet anëtar e cila është në dispozicion pa pagesë. Një bazë të dhënash e rëndësishme mund të jetë, për shembull, regjistri kombëtar i prokurimit, një dosje virtuale e një kompanie, një sistem elektronik i ruajtjes së dokumenteve, ose një sistem i para-kualifikimit.

<sup>12</sup> Rregullorja Zbatuese e Komisionit (BE) 2016/7 e datës 5 janar 2016 për krijimin e formularit standard të Dokumentit Unik Evropian i Prokurimit.

Pasi ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, autoriteti kontraktor nuk duhet të kërkojë nga operatori ekonomik, të cilit i është dhënë kontrata, që ai të paraqesë dokumente mbështetëse nëse autoriteti tashmë i zotëron këto dokumente. Për këtë qëllim, Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që bazat e të dhënave që përmbajnë informacione të rëndësishme për operatorët ekonomikë që mund të konsultohen nga autoritetet kontraktore të atij Shteti Anëtar mund të konsultohen, në të njëjtat kushte, nga autoritetet kontraktore të Shteteve të tjera Anëtare. Lista e këtyre bazave të të dhënave duhet të jetë e disponueshme, dhe lista duhet të jetë e përditësuar në e-Certis.

Për më shumë informacion mbi kualifikimin dhe përzgjedhjen e operatorëve shih Udhëzimin nr. 7 të SIGMA-s për Prokurimin Publik, *Përzgjedhja e operatorëve ekonomikë*.

## Mjetet e prokurimit

**Ankandet elektronike:** Ankandi elektronik (e-ankandi) është një proces elektronik që lejon paraqitjen e çmimeve të reja (të rishikuar në drejtim të uljes) dhe/ose paraqitjen e elementeve të reja të ofertave. Kjo bëhet në të dyja rastet, pasi të jetë ndërmarrë vlerësimi fillestar i plotë i ofertave. Ankandet elektronike zhvillohen në fazën e fundit të procesit të tenderit, i cili është realizuar deri në atë pikë në përputhje me një nga procedurat standarde të prokurimit - procedurën e hapur, procedurën e kufizuar dhe procedurën konkurruese me negociim, ose në përputhje me një mini-garë të drejtuar sipas një marrëveshjeje kuadër dhe në përputhje me sistemet dinamike të blerjes.

Ankandet elektronike përfshijnë një sistem elektronik në internet që u mundëson operatorëve ekonomikë që të dorëzojnë çmime të reja të rishikuara drejt uljes dhe/ose ndryshime të tjera të elementeve të ofertave të tyre për një kontratë të veçantë. Ankandi elektronik zhvillohet në kohë reale, dhe operatorët ekonomikë janë në konkurrencë të drejtpërdrejtë dhe anonime me operatorët e tjerë ekonomikë.

Ankandet elektronike mund të përdoren vetëm kur specifikimet mund të përcaktohen me saktësi të mjaftueshme. Subjekt i një ankandi elektronik që përdor mjete elektronike mund të jenë vetëm elementet e një tenderi që janë të përshtatshme për vlerësim. Ankandet elektronike nuk duhet të përdoren për kontratat e caktuara të shërbimeve dhe për kontrata të caktuara të punëve që kanë të bëjnë me performanca intelektuale, të tilla si projektimi i punimeve.

Në të gjitha rastet, në mënyrë që të organizojë një ankand elektronik, autoriteti kontraktor duhet të tregojë në njoftimin fillestar të kontratës që ai synon të përdorë ankandin elektronik.

**Katalogët elektronikë:** Katalogët elektronikë (e-katalogët) sigurojnë formatin për prezantimin dhe organizimin e informacionit në një mënyrë që është e përbashkët për të gjithë ofertuesit pjesëmarrës dhe që i nënshtrohen trajtimit elektronik. Ato përbëjnë një mjet që ndihmon për të lehtësuar prokurimin publik, në mënyrë të veçantë (por jo ekskluzivisht) si një mjet për të marrë pjesë në prokurim nëpërmjet marrëveshjeve kuadër ose brenda një sistemi dinamik blerjeje.

E shprehur në mënyrën më të thjeshtë të mundshme, katalogët elektronikë janë versionet thjesht elektronike të katalogëve tradicionalë të bazuar në letër që tregojnë detajet e mallrave ose shërbimeve të një operatori ekonomik. Një shembull i mirë është rasti kur autoriteti kontraktor lidh një marrëveshje kuadër me një furnitor të vetëm, e cila më pas operohet me anë të përdorimit të një katalogu elektronik të krijuar nga ofruesi duke i përshkruar produktet dhe çmimet në mënyrë të strukturuar, për të cilën është rënë dakord paraprakisht. Kur bëhet blerje sipas marrëveshjes kuadër, atëherë blerësit mund të aksesojnë informacionin në internet dhe, në qoftë se është gjithashtu në dispozicion edhe porositja elektronike, atëherë ata kryejnë të gjithë transaksionin e blerjes në internet.

Përparësitë e mundshme përfshijnë reduktimin e kostove të transaksioneve dhe të administrimit, thjeshtësimin e proceseve të porositjes, dhe reduktimin e blerjes së paautorizuar jashtë sistemeve të lejuara.

Kur është i nevojshëm përdorimi i mjeteve elektronike të komunikimit, atëherë autoritetet kontraktore mund të kërkojnë që ofertat të paraqiten në formatin e një katalogu elektronik, ose të përfshijnë një e-katalog ose katalog elektronik. Për më tepër, Shtetet Anëtare mund ta bëjnë përdorimin e e-katalogëve të detyrueshëm në lidhje me lloje të caktuara të prokurimit.

E-katalogët duhet të vendosen nga operatorët ekonomikë në përputhje me specifikimet teknike dhe format e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në përputhje me kërkesat për mjetet e komunikimit elektronik.

Kur autoritetet kontraktore pranojnë ose kërkojnë paraqitjen e ofertave në formën e katalogëve elektronikë, ato duhet ta deklarojnë këtë informacion në njoftimin e kontratës ose në ftesën për të konfirmuar interesin. Autoritetet kontraktore duhet të tregojnë në dokumentet e prokurimit të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me formatin, pajisjet elektronike të përdorura, si dhe strukturimin e lidhjeve dhe specifikimet teknike për katalogun elektronik.

**Sistemet dinamike të blerjes:** Direktiva përmban dispozita të veçanta që mbulojnë krijimin dhe funksionimin e sistemeve dinamike të blerjes (SDB). Rregullat që administrojnë SDB-të janë përshatur në mënyrë të konsiderueshme në funksion të Direktivës së mëparshme (2004/18/KE) për t'u mundësuar autoriteteve kontraktore që të përfitojnë plotësisht nga mundësitë e ofruara nga ky instrument.

SDB-ja është një sistem tërësisht elektronik që mund të përdoret për blerjet e përsëritura, standardizuara, karakteristikat e të cilave, që janë përgjithësisht të disponueshme në treg, plotësojnë kërkesat e autoriteteve kontraktore.

SDB-ja funksionon më tepër si një marrëveshje kuadër e drejtpërdrejtë e bazuar në internet, së cilës operatorët ekonomikë mund t'i bashkohen në çdo kohë. Ajo mund të ndahet në kategori të produkteve, punëve ose shërbimeve që përcaktohen në bazë të karakteristikave të prokurimit që do të ndërmerren në bazë të kategorisë në fjalë. Karakteristika të tilla mund të përfshijë referencën ndaj madhësisë maksimale të lejueshme të kontratave të veçanta vijuese ose ndaj një zone të caktuar gjeografike, në të cilën do të zbatohen kontratat specifike pasuese.

Në mënyrë që të realizohet prokurimi në bazë të SDB-së, autoritetet kontraktore duhet të ndjekin rregullat e procedurës së kufizuar. Procedura e kufizuar përdoret për të caktuar operatorët ekonomikë që janë të lirë që të aplikojnë për t'iu bashkuar sistemit në çdo kohë duke paraqitur kërkesa për pjesëmarrje. Të gjithë kandidatët që plotësojnë kriteret e përzgjedhjes duhet të pranohen në sistem. Të gjithë operatorët ekonomikë duhet të kenë mundësinë që të kërkojnë që të marrin pjesë në sistem gjatë gjithë periudhës së vlefshmërisë së SDB-së. Ndaj operatorëve ekonomikë të interesuar në SDB ose që janë palë në SDB nuk mund të vendoset asnjë tarifë para ose gjatë periudhës së vlefshmërisë së SDB-së.

Kur një subjekt kontraktor dëshiron të japë një kontratë duke përdorur një SDB-në, ai fton të gjithë pjesëmarrësit e pranuar - ose pjesëmarrësit janë pranuar me parë në kategorinë specifike të punëve, produkteve ose shërbimeve - të dorëzojnë ofertë për çdo prokurim të veçantë. Kontrata i jepet ofertuesit që ka paraqitur ofertën më të mirë në bazë të kriterëve të dhënies së kontratës.

Shih gjithashtu Udhëzimin nr. 11 të SIGMA-s për Prokurimin publik, *Mjetet e prokurimit*.

## Faturat elektronike

Direktiva nuk përfshin detyrimet lidhur me faturimin elektronik (e-faturimin), përveç kërkesës për të përfshirë informacionin mbi pranimin e faturave elektronike në njoftimin e kontratës, kur kërkohet. Megjithatë, Direktiva 2014/55/BE për faturimin elektronik në prokurimin publik parashikon që Shtetet Anëtare duhet të sigurojnë që autoritetet kontraktore dhe subjektet marrin dhe përpunojnë faturat elektronike që përputhen me standardet e BE-së për faturimin elektronik.

## Informacion i mëtejshëm

### Botime

*Manuali i Trajnimit për Prokurimin Publik* – Moduli C4, Botimet e OECD-së, Paris.

<http://www.sigmaweb.org/publications/public-procurement-training-manual.htm>

### Udhëzimet e Prokurimit Publik

<http://www.sigmaweb.org/publications/key-public-procurement-publications.htm>

SIGMA (2016), *Shpallja*, Udhëzimi 6, Botimet e OECD-së, Paris.

SIGMA (2016), *Kontratat poshtë kufirit monetar*, Udhëzimi 15, Botimet e OECD-së, Paris.

SIGMA (2016), *Organet qendrore blerëse*, Udhëzimi 20, Botimet e OECD-së, Paris.

SIGMA (2016) *Marrëveshjet kuadër*, Udhëzimi 19, Botimet e OECD-së, Paris.

SIGMA (2016), *Mjetet e prokurimit*, Udhëzimi 11, Botimet e OECD-së, Paris.

SIGMA (2016), *Përzgjedhja e operatorëve ekonomik*, Udhëzimi 7, Botimet e OECD-së, Paris.

### Burime të tjera

Komisioni Evropian (2013), *Prokurimi elektronik i plotë për të modernizuar administratën publike*, COM (2013) 0453 final, Bruksel.

<http://ec.europa.eu/transparency/regdoc/?fuseaction=list&coteld=1&year=2013&number=453&language=EN>

Komisioni Evropian (2012), *Strategjia për prokurimin elektronik*, COM (2012) 0179 final, Bruksel.

<http://ec.europa.eu/transparency/regdoc/?fuseaction=list&coteld=1&year=2012&number=179&language=EN>

Komisioni Evropian (2010), Dokumenti i Gjellbër mbi zgjerimin e përdorimit të prokurimit elektronik në BE, COM (2010) 571 final, dhe Dokumenti shoqërues i Punës i Stafit të Komisionit SEC (2101) 1214 final, Bruksel.

<http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX:52010DC0571>

Faqja e internetit për prokurimin elektronik: <http://ec.europa.eu/growth/single-market/public-procurement/e-procurement/>